



Mundet vallë liberalizmi ta tolerojë Islamin?

Description

Nga Abdel Hakim Murad*

Lipset vallë të jesh liberal për t'i përkitur Perëndimit? Me gjithë mohimet e sjellshme multikulturaliste, kjo pyetje shtrohet para nesh gjithnjë e më ngulshëm.

Bashkimi European, teksa shtrëngohet të njëtojë një vizion të njëjtë kulturor sikurse edhe ekonomik, luan rregullisht me deklarata të mëdha mbi Europën si një vizion bashkësie njerëzore, sukcesi i së cilës përforcon modelin universal, nxitur tashmë edhe për pjesën tjetër të njerëzimit. Liberalët europianë – me Iluminizmin, shoqërinë civile, institucionet demokratike dhe kodet e tyre për të drejtat e njeriut – duket nganjëherë sikur vetëpërkufizohen si një Mesi shekullare, të vullnetshëm dhe të gatshëm për të shpëtuar botën. T'u rezistosh, nënkupton kështu të rreshtohesh me njerëzinë e papënduar, mëkatore.

Sidoqoftë, ne europianët gjendemi në fakt në mes të një diskutimi të vështirë. Vazhdimisht grindemi me vetveten mbi përkufizimet e përkatësisë. Arrijmë të bashkohemi për të ndërtuar Airbus-in, por do të mund vallë të bashkohemi rreth një ideali moral apo kulturor? Cili është, në fund të fundit, terreni i saktë historik për bashkimin kulturor europian? Dhe – kjo tashmë ngjan si shqetësimi më i madh i kontinentit – si mund të përshtaten myslimanët në të?

Islami dhe tradita perëndimore

Ndoshta ndihmon t'i hedhim një sy rrënjëve të largëta të Europës. Homeri, kohë më parë, na tregoi se Europa, vajza e mbretit të Fenikisë, u rrëmbye nga Zeusi, u dhunua prej tij dhe u degdis në ishullin e Kretës, ku dhe i dha jetë europianëve. Ka diçka emblematike dhe transgresive në këtë mit origjinash: një zonjushë libaneze shkukur nga gjiri i Azisë dhe vendosur në një qoshe të kontinentit, i cili përfundimisht barti emrin e saj.

Fillimi i historisë sonë është një bastisje e dhunshme europiane ndaj Azisë, një imigracion fatlig, dhe një konfiskim identiteti. Mundet ndoshta ta gjurmojmë deri në këto thellësi – dhe letërsia e Europës nis, në fakt, me Homerin – ambiguitetin e Europës ndaj vetes dhe vlerave të saj. Megjithatë, Europa mundi ta gjejë vetveten, dhe të zbulojë sinoret e shpirtit dhe trupit të saj, shumë kohë pas këtij prologu klasik.

Për romakët që Mesdheu ai që përkufizonte bërthamën e territoreve të tyre dhe jetës së tyre tregtare dhe fetare. Roma i përqafoi pa dallim brigjet europiane, afrikane dhe aziatike të Detit të Mesit. Por ndërsa e shihte veten si sipërore, rrallë u përpoq ta imponojë filozofinë apo vlerat e saj shoqërore mbi të tjerë.

Ngurojmë kësisoj ta pranojmë klisenë e zakonshme se në kohën tonë është ringjallur historia e lashtë: Amerika është Roma, Europa është Athina, ndërsa Islami një Judë pambarimisht shqetësuese. Roma e Lashtë dhe Athina nuk kishin programe sistematike të universalizimit të vlerave të tyre, qoftë edhe përbrenda kufijve të ndikimit të tyre politik, dhe ende më pak i inkurajuan ata kombet e tjera t'i pranonin besimet e tyre shoqërore.

Ndërsa Islami u shfaq në shekullin e shtatë, brigjet afrikane dhe aziatike ishin humbur. E tkurrur brenda burimeve të saj, Europa u përpoq të përkufizojë vetveten, aso kohe sikurse edhe tashmë, si një zgjatim krahasimisht i vogël i një mbetjeje të lashtë, të cilën saraçenët e humbën. Qysh prej asaj kohe, zhvilloi idetë e veçantisë dhe drejtësisë së saj shoqërore universale.

Historiani Fernand Braudel ngulmon se që goditja elektrike e Betejës së Poitiers-ë më 732, kur marshimi i arabëve dhe berberëve u ndal përfundimisht, çka u dha frankëve, dhe prej këtej europianëve, ndjesinë e vetvetes. Ahen, kryeqyteti i Charlemagne-it, dukej se shtrihej simbolikisht në të dyja brigjet e Rinit, duke i shndërruar në të pakuptimtë kufijtë e vjetër romakë. Gjermanët barbarë që i sollën fundin Romës, e që tashmë sundonin në Francë e Gjermani, sikurse kishin sunduar në Itali dhe Spanjë, pretendonin tashmë se qenë pasardhës të imperum-it.

Kulti thuajse obsesiv me gjuhën latine dhe mitologjinë klasike, që karakterizoi arsimin europian deri vonë shekullin e njëzetë, tregon sa ankth kishin gjermanikët dhe popujt e tjerë 'europianë' ta shihnin vetveten, më tepër se saraçenët që kontrollinin pjesën më të madhe të Mesdheut, si pasardhës të Perandorisë Romake.

Kur osmanët e morën dhe e plaçkitën Konstandinopojën më 1453, sultan Mehmeti II i njohu vetes titullin e perandorit romak, por Europa këtë e hodhi poshtë kategorikisht. Sikundër Bibla hedh poshtë Ishmaelin në dobi të Isakut, ashtu edhe Europa është bashkuar në asgjë më shumë se hedhjen poshtë të pretendimeve të Islamit për pjesëmarrje legjitime në bekimet e dhuruara nga lashtësia, dhe nga patriarkët e tjerë, Platoni dhe Aristoteli.

Në fakt – dhe kjo tashmë vihet re gjerësisht nga mbrojtësit liberalë të veçantisë europiane – Islami, në një pjesë të madhe të historisë së tij, ishte pasardhësi kryesor i helenizmit, gjeografikisht dhe intelektualisht. Megjithatë, Europa nuk do ta shihte Islamin si një pasardhës i vërtetë i Athinës, më shumë se ç'do t'i lejonte Ishmaelit autoritet legjitim mbi Jeruzalemin.

Arsyeja qe Krishtërimi. Murgjit e krishterë e shihnin vetveten si interpretuesit e vërtetë të helenizmit, megjithë huazimet nga Ibn Rushdiu dhe Gazali. Roma, metropoli i vetëm trashëguar nga bota klasike, u mendua të qe pasardhësja e pasurive të asaj bote, e cila ishte shpërngulur drejt perëndimit më tepër se kish qëndruar në vendet e saj të origjinës në Antioki, Efes, Kirenë dhe Aleksandri. Saraçeni qe një furacak, një parvenu.

Sajë të njëjtit furor Teutonicus, i cili tulari dhe rrënoi Romën, frankët i mbajtën larg pasardhësit e rremë, dhe për më tepër, gjatë Kryqëzatave, u gjenden të bashkuar si europianë në një kundërsulm, i cili e solli Jeruzalemin sërish në duar të krishtera.

Qysh prej asaj kohe e deri më sot, Europa, e ndjekur nga bijtë e saj në Amerikat e spastruara etnikisht, ka qenë e sigurt për pronësinë e saj të vetme dhe të vërtetë, jo thjesht sa i përket profecisë së lashtë semite, por edhe trashëgimisë së Athinës me të cilin bashkëjetoj në një martesë kaq të ndërlikuar dhe shpesh të lëkundshme.

Një orientalizëm më i vjetër do të pretendonte se Islami, semitizmi madhor, e nuhati shkurtimisht Greqinë, por më pas i ktheu shpinën. Ky është rrëfimi sipas të cilit teologu Gazali i ra kambanës së vdekjes së filozofisë greke në botën e Islamit. Helenizmi, sipas Leo Strauss-it me shokë, mund të gjente vend vetëm në hanin europian; Islami, me barrën e tij të literalizmit skriptural, e trajtoi atë, në rastin më të mirë, si banor të huaj. Kjo nuk gjen zbatim vetëm në metafizikë, por edhe në teori politike – apoteoza e shkurtër myslimane e Platonit në faqet e al Farabiu.

Strauss-i i pati të shumtë admiruesit: ogurzisht, Donald Rumsfeld dhe Paul Wolfowitz radhiteshin midis tyre, së bashku me mendimtarë të tjerë të së djathtës së re islamofobe në Europë. Më tej, fjala e famshme e papës Benedikt më 2007 në Regensburg mëtoi gjithashtu t'i paraqiste myslimanët si pasardhës të padenjës të trashëgimisë klasike të racionalitetit dhe të të drejtave, të cilat, sipas këtij trashëgimtari të Zyrës së Shenjtë, i përkasin vetëm Europës.

Së fundmi, punimet më të mira akademike, sikurse ato nga Robert Wisnosvsky, e kanë hedhur poshtë këtë: së tashmi, jemi më të prirur t'i vështrojmë Xhujejnin, Gazalin dhe Raziun si mbrojtësit më të mëdhenj të një përzgjedhjeje, vetëm se thellë të përbrendësuar, të arsyes greke. Etika greke vijon të jetojë me forcë në faqet e Miskavejhit, al Ragip al Isfahanit dhe Gazalit.

Në mendimin politik posaçërisht, temat e vjetra vijuan të gjallojnë në manualët e shtetarisë, studjuar me kujdes nga perandorët osmanë, safavidë e mogulë dhe vezirët e tyre të mëdhenj. Dhe nëse Platoni u modifikua drastikisht nga Sira, kjo nuk ish aspak e keqe, gjithë duke ditur se Platoni mjaft shpesh qe armik i shoqërisë së hapur.

Triumfi i liberalizmit

Përbrendësimi i filosofisë së lashtë, duke përfshirë edhe ato fije nga të cilat origjinon, në fund të fundit, mendimi modern liberal, ngjau ndryshe në Islam dhe në botën e perëndimore. Kjo është një arsye pse Athina, në Europë, e mposhti përfundimisht Jeruzalemin, dhe pse filozofia e një përthyerje gjithnjë e më shekullare mposhti teologjinë.

Summa Contra Gentiles e Akuinasit, e cila ish shkruar për të ndihmuar ta siguronte teologjinë e krishterë në tokat e fituara prej myslimanëve, propozonte një simbiozë të filozofisë dhe biblikes, e cila, për shumicën e evropianëve, e ka tejkaluar tashmë kredibilitetin e saj.

I njëjti interval i krishterë në Europë, i cili parashtrroi pretendimin ndaj epokës klasike duke u mbështetur, ndoshta çuditërisht, në përkime të dukshme përgjatë Dhjatës të Re greke, është lëkundur për t'u zëvendësuar nga paganizma energjikë ose nga një shekullarizëm burokratik, shpesh militant. Prej këtej edhe vendimi i hartuesve të Kushtetutës europiane për të përfshirë një përmendje për Tuqiditin e për t'i kaluar në heshtje shekujt e krishterë.

Një shtresë e re ateistësh triumfalistë – Richard Dawkins, Anthony Grayling dhe të tjerë – e sulmojnë fenë tashmë për pamundësinë e saj për të prodhuar një shoqëri të paqte dhe të drejtë. Njëtimet etike liberale kundër fesë dëgjohen tashmë shumëfish më dendur se kundërshtimet e vjetra për fenë bazuar në problemin e së keqes ose në pamundësinë në Librin e Gjenezës.

Kjo ndoshta nisi gjatë fundshekullit të nëntëmbëdhjetë ndërsa gjithë njerëzit e arsyeshëm u shfaqën kundër Silabusit të Gabimeve të papës Piu IX, i cili anatemonte nocionet e Iluminizmit rreth lirisë fetare dhe ndarjes së fesë nga shteti. Neni 80 i Silabusit shpall ekskomunikim ndaj çdokujt që pretendon se 'papa i Romës mund, dhe duhet, të pajtohet dhe të bjerë dakord me progresin, liberalizmin dhe qytetërimin modern'.

Qysh prej Koncilit të Dytë të Vatikanit në vitet 1960, këto anatema janë të vështira të përfytyrohen, kur edhe Vatikanit është duke e rishpikur vetveten si mbrojtës i pikërisht këtyre opinioneve liberale – ose të shumë prej tyre – të cilat një shekull më parë do të kishin rezultuar në përjashtimin nga sakramentet, prej ku edhe në vendim për dënim të përjetshëm. Kundërshtia e Vatikanit ndaj dënimit me vdekje dhe mbështetja ndaj lirisë fetare përbëjnë dy shembuj ikonikë. Triumfi i liberalizmit është aq i plotë sa pakkush mund ta sjellë ende ndërmend sot kundërshtinë e vjetër dhe të sertë të krishterë ndaj tij.

Falë këtyre kapitullimeve, Europa, e cila historikisht bëhej njësi duke u përballur me myslimanët, apo duke i dëbuar ata nga Spanja, Franca, Siçilia dhe Ballkani, konsiderueshëm ka hequr sot dorë nga dallueshmëria e vizionit fetar të shoqërisë që ia mundësoi qenien.

Liberalizmi, gjenealogjia e shtrembër e të cilit zë fill në shqetësimet e largëta në Athinën e lashtë, dhe kontribuesit biblikë të të cilit, pretenduar nga disa amerikanë, janë ndoshta thjesht imagjinarë, e ka zëvendësuar mendimin e vjetër teokratik, i cili ka tepruar vetëm në margjinat e qarqeve të së djathtës dhe në ato të monarkistëve.

Shekullariteti është kryesisht një shpikje e kontinentit, i cili qe djepi i monarkizmit të krishterë; sot, në të vërtetë, në një botë e cila mund ta bartë shekullarizmin edhe jashtë, por jo shekullaritetin, ai është thuajse një monopol evropian. Kontinenti i Zotit është shndërruar kështu në epruvetën e një materializmi gjithnjë e më të sigurt.

Pjesërisht për këtë arsye, ndërsa pilotët e tryezave të Brukselit projektojnë ardhmërinë, këta e dinë se zgjerimi i ardhëm i Bashkimit të tyre duhet të jetë gjithnjë drejt Lindjes, jo drejt Jugut.

Drang nach Osten ('shytja drejt Lindjes') e Eurolandit, kuptueshëm mund ta shpjerë Europën në tridhjetë vjet në Vlladivostok, por Tangjeri që ndodhet vetëm njëzet milje përkarshi detit, e që në epokën klasike përbënte rrugëkalim kryesor dhe jo pengesë, pranohet zakonisht të jetë psikologjikisht tokë e huaj, e largme.

Kështu, sot, sikurse rregullisht në të shkuarën e krishterë, nyjëtimet europiane mbi vetveten, nëse djathtiste ose libertariane, reduktohen zakonisht në marrëdhënien me Tjetrin domethënës, të sferës së saraçenit dhe turkut.

Përrjashtimi i nevojshëm i Turqisë

Në vijim të thyerjes të kufirit të Europës pas zbulimeve të mëdha gjeografike, bota islame u shtrëngua gradualisht t'i nënshtrohet modeleve europiane të qeverisjes dhe interesit ekonomik.

Sot, elitat në botën myslimane post-koloniale janë kryesisht europiane, më tepër se aderuese në vlerat vendase. Nganjëherë, mospëlqimi i tyre i zjarrtë i indigjenes i bën të ngjajnë më monarkistë se mbreti.

Me këta të konvertuar Brukseli nuk ka asnjë grindje domethënëse, megjithëse rregullisht shtanget përballë korrupsionit të thellë dhe mizorisë së shpeshtë të shtresave të perëndimorizuara në kolonitë e kaheshme. Sidoqoftë, marrëdhëniet me këto regjime nuk e tejkalojnë çështjen e të drejtave të njeriut. Elitat duhet të aderojnë në normat kushtetuese, sikurse edhe në format shekullare të Europës.

Gjithsesi, eurokrati është nervozisht i ndërgjegjshëm se, sikurse e tregojnë edhe ngjarjet aktuale, këto elita ngjasojnë me një cipë të brishtë tendosur përmbi një det ndryshimesh kulturore. Bota myslimane, ndoshta bota jo-perëndimore, mund t'i ngjajë një modeli gjeologjist të Tokës. Planeti, jo shumë thellë, është i gjallë dhe i lëvizshëm, një masë e lëngshme magme; por në sipërfaqe bashkëjetojnë sikletshëm pllaka të mpiksura shkëmbi.

Tensionet, bie fjala, midis Marokut dhe Algjerisë, janë tensione midis shtresave të ftohta europiane, jo midis popullsive shpesh fetare tëposhtë, për të cilat sinoret e skicuara prej brezave të shkuar të hartëbërësve kolonialë nuk u korrespondojnë asfare dallimeve gjuhësore dhe etnike vendase. Elitat shekullare, duke pretenduar vlera liberale, i shtrëngojnë frymën ndjesisë fetare të masës jo-liberale. Ky shtrëngim fryme mund të jetë aq i dhunshëm sa të shfaqë herë-herë terroristë të traumatizuar që të tmerrojnë botën, dhe të konfirmojnë kështu liberalët në mbështjeten e tyre të sikletshme për regjimet.

Ky tension midis elitave autokrate të mbështetura nga qeveritë liberale europiane dhe masave ende kryesisht fetare me dëshirën e tyre për të hyrë në sheshin publik, është bërë tashmë aq i gjallë sa që llava ka shpërthyer në shumë e shumë vende myslimane. Rezultati është shpesh një lloj krize për ndërgjegjjen liberale, ose një ndryshim kahu i menjëhershëm dhe i mirëllogaritur (sikurse e kemi vënë re kudo në vendet myslimane gjatë vitit të shkuar).

Teksa lebetiten nga demografia dhe imigracioni, teoristët e Europës janë të ndërgjegjshëm për këtë; prej ku edhe vështirësia, për shembull, e debatit në vazhdim mbi anëtarësimin e Turqisë në Bashkimin European. Qeveria e Erdoganit u parashtron liberalëve një paradoks. Më pak shekullare se paraardhëset e saj, ajo është më e angazhuar me të drejtat e njeriut dhe pluralizmin demokratik, dhe është entuziaste për të përthyer projeksionet e ushtrisë në sferën politike. Gjeneralët, me laicizmin e tyre nofullshtënguar, pretendojnë të jenë garantë të projektit të Ataturkut për ta rikrijuar Turqinë në

imazhin e Europës; sakaq, Europa nuk është më kontinenti nationalist, shpesh fashist, që qe në vitet 1920 e 1930 ndërsa qemalizmi merrte formë.

Prej këtej edhe enigma e eurokratëve. Shumë shtetarë liberalë europianë, veçanërisht në thelbin e shteteve të 'Charlemagne'-it, Francës dhe Gjermanisë, e kundërshtojnë anëtarësimin e Turqisë mbi baza të cilat kanë të bëjnë qartësisht me zakonet e lashta të Europës së vetëpërkufizimit si diçka që, në fund të fundit, është jo-myslimane.

Europa mund të jetë ekonomikisht përfshirëse, dhe nxehtësisht liberale dhe libertariane, por përfundimisht, që të jetë vetvetja, lipset të jetë përjashtuese ndaj jo-të krishterëve, dhe mbi të gjitha ndaj jo-myslimanëve. Thirrja e vjetër e Kryqëzatave 'të krishterët kanë të drejtë, paganët e kanë gabim', është modifikuar duke i zëvendësuar 'të krishterët' me aktivistët homoseksualë dhe komisionerët e të drejtave të njeriut.

Nuk është e pamundur që Turqia të pranohet, ndoshta pas dy a më shumë dekadash. Megjithatë, propozimet në qarkullim parashikojnë përjashtimin e Turqisë nga Traktati i Amsterdimit, sa i përket popullatës myslimane të Turqisë. Qytetarët e BE-së do të mund të jetojnë në Turqi, por t'u lejosh turqve të emigrojnë lirisht në Europë do të qe e tepërt të meditohej nga elektoratet.

Së tashmi, ky duket të jetë kompromisi që Ankaraja është detyruar të pranojë. Të tjera marrëveshje me hapësira myslimane sikundër Shqipëria, Bosnja dhe ndoshta Azerbajxhani, mundet ndoshta të detyrojnë kushte të njëjta. Një Europë gjithnjë e më tepër e rehatshme me ndalime minarësh e nikabesh do të jetë e lumtur ta vështrijë këtë anshmëri të çuditshme si të drejtë dhe të duhur.

Intolerant ndaj intolerancës

Meqenëse e parashtruam situatën tonë të çuditshme, le të merremi me pyetjen: për të qenë europianë, lipset vallë të jemi liberalë? Këmbëngulja e Europës liberale ndërsa skicon skajet e kufijve të saj në përjashtim të pjesës apo të krejtë të Islamit, nënkupton vallë përkufizime të brendshme të përkatësisë?

Nëse bezdisemi të vërejmë bankënotat e shplara të euros, prodhim i kërkimeve të zgjatura gjatë viteve '90 për një simbol të përbashkët europian, vërejmë se simboli kyç që u përdor përfundimisht ishte ravijëzimi i vetë kontinentit, i cili megjullon në boshllëk teksa mbërrin në vendet e banuara prej myslimanëve. Simbolet e turbullta të urës merren prej 'shtatë moshave' të kulturës dhe dizajnit europian, megjithëse, natyrisht, nuk kish asnjë rrezik të mërzitnin europianët me ndonjë gjurmë harqesh moreske.

Për burokracinë e Brukselit, nënkuptueshëm nuk mund të gjendet simbol më i përshtatshëm i Europës sesa ai që sugjeron jo-myslimanitet. Ç'mendon, atëherë, një mysliman europian për vetveten kur e përdor këtë monedhë? Një përjashtim i ndëgjegjshëm mbi bazë fetare në kufij, ka vallë ndikim në solidaritetin dhe përkatësinë e brendshme? Lipset vallë që Europa liberale të krijojë një mur të brendshëm kundër migrantëve myslimanë dhe pinjollëve të tyre, habitshëm fetarë?

Megjithë diskutimet e guximshme mbi unitetin europian, realiteti ngushëllues në terren është se nuk ka kurrfarë konsensusi. Modeli francez, rrënjosur në Iluminizmin antiklerikal, është kryekëput përjashtues ndaj përkatësisë fetare të çdo lloji prej vetë ndjesisë së përkatësisë së tij. Kjo nuk lidhet vetëm me Islamin: është bërë e qartë tashmë prej më se një shekulli në përgjigjen e Republikës ndaj Silabusit të

Gabimeve: u miratua një ligj i cili i ndalonte priftërinjtë ta përmendnin dokumentin e papës në katedra. U krijua kështu një proces përmes të cilit shekullariteti liberal të mund të korrte fitore mbi lirinë e fjalës. Dhe katolicizmi, megjithëse viktimë e antiklerikalizmit, u konsiderua kështu së paku si indigjen.

Në hallet më bashkëkohore të Republikës me Islamin, kujtimet e Kryeqëzatave dhe lufta e pistë në Algjeri e kanë bërë përjashtimin e myslimanitetit, në emër të laicitetit republikan, veçanërisht të thjeshtë dhe emfatik. Konsesusi me bazë të gjerë midis liberalëve se gratë që mbajnë nikab duhen arrestuar nga policia është vetëm shembulli më i freskët i kësaj.

Në fakt, është ndoshta e vërtetë se partitë e ashtuquajtuara të djathta të skajshme, sikurse Front National i Le Pen-it, nuk janë në fakt edhe aq larg në të djathtën e spektrit politik. Këto duhen parë më mirë si parti liberale, me qasje shtrënguese, dhe politikat e tyre sociale e fiskale i vendosin ato diku në qendrën e djathtë të spektrit politik, ndërkaq aq të dhëna pas të vërtetës unike të liberalizmit sa që kërkojnë t'i ndëshkojnë të gjithë ata që nuk u binden besimeve shoqërore liberale të tashme.

Si shembull mund të shërbejë Geert Wilders, politikani ndoshta më i njohur i Hollandës. Në më të shumtën e këndvështrimeve kyçe, politikisht Wilders-i gjendet disi në të majtë ose në qendër. Por është aq i dhënë pas liberalizmit sa që dëshiron të detyrojë një tatim vjetor prej 1000 eurosh për mbajtëset e shamisë, të ndalojë shitjen e Kur'anit si dhe ndërtimin e xhamive të reja. Në Zvicër, po ashtu, anketimet tregojnë se ndalimi në fuqi për ndërtimin e minareve ka më shumë gjasa të mbështetet nga votuesit e majtë, sesa prej atyre të së djathtës tradicionale.

Mund të ndodhë që, teksa Europa përkufizon sinoret e saj natyrale si të përputhshme me kufijtë me Islamin, përkufizimet në zhvillim e sipër mbi qytetarinë dhe provimet e ndryshme që aplikohen mbi ata që kërkojnë qytetari, të ballafaqohen kryesisht me Islamin si alternativa domethënëse, si modeli për çfarë nuk është europiane dhe e pranueshme.

Një shembull i mirë është manuali 76-faqësh që udhëzon burokracinë për shqyrtimin e kërkesave për qytetari gjermane. Provimet formale të qytetarisë në Gjermani përfshijnë pyetje mbi lirinë e fesë, orientimin seksual dhe statusin e grave, për t'u lejuar burokratëve të përjashtojnë individë, besimet shoqërore të të cilëve konsiderohen të bien ndesh me rrymën kryesore liberale.

Në disa provinca, sikundër në Hesse, pyetjet e posaçme për myslimanët janë mjaft këmbëngulëse. Për shembull: 'Duhet që një grua të lejohet të shfaqet në publik pa një të afërm mashkull?'. Një pyetje në Baden-Wurttemberg shtrohet: 'Përfytyroni që djali juaj në moshë madhore vjen dhe ju thotë se është homoseksual dhe se planifikon të jetojë me një burrë. Si do të reagonit?'. Një tjetër, parashikueshëm, thotë: 'Çfarë mendoni nëse një burrë është i martuar me dy gra në të njëjtën kohë?' Dhe sërish: 'Në Gjermani, klasat e fizkulturës dhe notit janë pjesë e programit normal shkollor. Do ta lejonit vajzën tuaj të merrte pjesë?'

Rregullat u japin të drejtë burokratëve deri edhe ta tërheqin qytetarinë nëse dyshohet për një orientim fetar shumë konservator, ose nëse opinionet apo sjellja e mëpasme e qytetarit tregojnë se ai ose ajo ka gënjer gjatë provimit. Asnjë konservator nuk do të lejohet të kalojë poshtë radarit; nëse e bëjnë, mund t'u konfiskohen pasaportat dhe do të deportohen.

Në këndvështrimin e Eren Unsal-it të Bashkimit Turk, 'këto provime janë paragjyquese, negative dhe anti-islame. Po shohim një politikë imigracioni më kufizuese, fytyra e së cilës është anti-myslimane'. Dhe një përfaqësues tjetër mysli manësh thotë edhe se: 'supozimi kushtetues i pafajësisë nuk aplikohet më mbi mysli manët'.

Këto protesta mysli mane lihen zakonisht mënjanë nga komentuesit gjermanë, deri kur gazeta *Sddeutsche Zeitung* botoi një memo të brendshme të rrjedhur nga Ministria e Brendshme dërguar zyrtarëve të imigracionit. Sipas këtij dokumenti, autoritetet e imigracionit duhet të kenë, çfarë ajo quan, një 'dyshim të përgjithshëm' për besnikërinë e mysli manëve ndaj Gjermanisë. Vijnë të shpjegojë se 'devocioni i brendshëm ndaj Gjermanisë' duhet të vihet automatikisht në dyshim në raset e kërkesave të mysli manëve për qytetari. Udhëzimet qeveritare të rrjedhura vijnë më pas të thonë se: 'europianët, amerikanët dhe qytetarët e vendeve të tjera, të cilët janë jashtë çdo dyshimi, nuk duhet të bien në kontakt me provimin'.

Një shembull tjetër ndërhyrjeje liberale vjen nga tentativat e qeverisë Gjermane për të krijuar një shtresë udhëheqësish fetarë mysli manë, vlerat e të cilëve pajtohen me ato të shumicës liberale të vendit. Qeveria organizoi shkollën e parë vendase të programit të trajnimit të imamëve në Universitetin e Munsterit për ta promovuar këtë agjendë, por emëroi si drejtor programi historianin Sven Kalisch, librat e të cilit pretendojnë se Profeti Muhamed nuk ka ekzistuar. Katër organizatat kryesore mysli mane në Gjermani u tërhoqën nga programi në shenjë proteste, duke shkaktuar kritikën e qeverisë për pretendime 'tendencash konservatore-fundamentaliste'.

Në këtë rast, sidoqoftë, disa liberalë ranë dakord se emërimi i një njeriu që nuk besonte në ekzistencën e Profetit në një program trajnimi imamësh, që ndoshta një gjykim i gabuar nga ana e autoriteteve. Sikurse me provimin mysli man, ekperimenti i Munsterit gjeneroi jo thjesht fyerje, por një dozë të paqtë gazi në kurriz të ndërhyrjeve liberale.

Në përgjithësi, në Gjermani, impulse të thella volkisch janë duke u ndezur në heshtje, të stolisura në gjuhën e liberalizmit, sikurse edhe nazizmi në vitet 1930 justifikonte vetveten ndaj jo-praktikuesve si një lloj socializmi. Gjithë sikurse debatet që çuan në ligjet e Nurembergut u parandoqën nga debate të nxehta mbi gjermanitetin e vërtetë dhe të dëlirë, supozimet e të djathës së skajshme janë duke përshkuar gjithashtu rrymën kryesore.

Në mars të vitit 2011, ministri i brendshëm, Hans-Peter Friedrich shpalli se: 'Të thuash se Islami i përket Gjermanisë, nuk është një fakt që mbështetet nga historia', duke i bërë kështu jehonë temës më të lashtë në të vetë-kuptuarit gjerman. I vjetri 'semit i brendshëm', që u zhduk gjatë Rajhut të Tretë, është zëvendësuar tashmë me semitin e lashtë ante portas, i cili ka marrë tashmë qytetari, por kurrë, në këndvështrimin e Friedrich-ut, nuk mundet të përkasë.

Në Francë, sikurse mysli manët e dinë përgjithësisht, fushata liberale për të kufizuar praktikën islame, herë e mbrojtur e herë e kundërshtuar nga e djathta, ka gjeneruar një paradoks interesant, kurrjë më pak informues se ai i prodhuar nga dështakët gjermanë.

Megjithë mbrojtjen e furishme, më 1989, të së drejtës të një botuesi për të shtypur një përktim në frëngjisht të romanit të Selman Rushdisë, *Vargjet Satanike*, më 1994 qeveria franceze vuri në fuqi një seri ndalesash, të cilat kërcënonin me burg gjithkënd që gjendej të kish një prej libërthave të shkrimtarit jug-afrikan Ahmed Deedat. Për ata që i kanë lexuar këta pamflete kjo mund të tingëllojë e çuditshme, meqënëse autori nuk mbron kurrfarë dhune, të cilitdo lloji. Por Franca liberale është e qartë: ligji i 31 majit 1994 e përshkruan librin e tij Jezusi në Islam si të ngjashëm të shkaktojë 'kërcënim ndaj rendit

publik' (des dangers pour l'ordre public) për shkak të 'toneve të dhunshme anti-perëndimore dhe nxitjes së urrejtjes raciale'. Të ndrojtur, myslimanët treguan me gisht drejt kundërthënies, por establishmenti liberal që i qartë: Deedat-i është i rrezikshëm dhe myslimanët që e kanë këtë libër duhen ndëshkuar.

Mbretëria e Bashkuar, e cila as që do ta ëndërronte ta ndalonte Deedat-in, është përgjithësisht më e kujdeshme në përpjekjet e saj për të përhapur besimet liberale në gjirin e minoriteteve. Por një vlerësim i freskët nga Ofsted-i për cilësinë e dobët në trajnimet e 'qytetarisë' në shkollat e mesme fetare mund të dëftojë për formën e ardhshme të gjërave.

Edhe pa myslimanët Ofsted-i e ka gjetur detyrën. 'Qytetaria' është bërë pjesë e programit kombëtar vetëm në dhjetë vitet e fundit, dhe Ofsted-i konfirmon se mësimdhënia e kësaj lënde të mistertë është jashtëzakonisht e parregullt në të gjithë vendin; thuhet, në fakt, se është lënda më e keqdhënë në të gjitha shkollat kombëtare. Situata është aq e keqe sa një në dhjetë nxënës në Britani nuk është, me sa duket, as në dijeni se ç'janë orët e qytetarisë, edhe pse e ka ndjekur lëndën. Të paktë janë ata që angazhohen aktivisht me çështjet liberale që ngrihen në trajnimet e qytetarisë.

Arsyeja duket të jetë apatia e përgjithshme ndaj politikës dhe ideologjisë që gjallon tashmë ndër mjaft adoleshentë, rezultat ndoshta i përbërjes eskapistike të argëtimit masiv rinor, së bashku me perceptime më të mëdha shoqërore se përkufizimet e vjetra të sovranitetit dhe vetëdijes kombëtare po gërryhen paepur nga globalizimi dhe interneti. Vetëm 64 përqind e nxënësve në mbarë kombin indentifikohen si 'britanikë'.

Në shkollat myslimane, ku trajnimi i qytetarisë është, me sa duket, ende më i çrregullt, Ofsted-i thotë se: 'Nuk duhet ta lejojmë njohjen e diversitetit të shndërrohet në apati përballë cilësdo vështirësie të koherencës sonë si komb. Duhet të jemi intolerantë ndaj intolerancës'.

Mendoj se këtu gishti zyrtar i drejtohet thembrës së Akilit të etikës shekullare liberale. Nëse lipset të jemi intolerantë ndaj intolerancës, mundet atëherë liberalizmi të tolerojë tjetër gjë përveç vetvetes? Nëse Europa e përkufizon qytetarinë në funksion të aderimit në një shabllon të përcaktuar moral, me gjithçka tjetër të përkufizuar si të patolerueshme, si mundet Europa ta përjetojë ndonjëherë pozitivisht vërtet të ndryshmen, e cila është më shpesh e lidhur me fenë -e mirë apo të keqe?

Vakuumi i vlerave të Europës

Një ikonë e veçansisë europiane u shfaq më 2004 kur politikani italian Rocco Buttiglione u detyrua të jepte dorëheqjen si komisioner europian ndërsa doli në pah se ai mbështeste vijën e Vatikanit mbi homoseksualitetin. Pavarësisht këmbënguljes së tij se besimi i tij në mëkatinë e praktikës nuk do ta ndikonte në marrjen e vendimeve në jetën publike, konsensusi i burokracisë europiane e detyroi të dorëhiqet. Ministri italian i Drejtësisë, Roberto Castelli, kundërshtoi më kot, duke e quajtur ndalimin 'një vendim që tregon fytyrën e vërtetë të Europës, një fytyrë e cila nuk na pëlqen. Është fundamentaliste, çka është kryekëput e papranueshme'. Megjithatë, këndvështrimi i tij prodhoi vetëm vrenjtje.

Myslimanët e kanë përcjellë me shqetësim këtë provë goditëse se në ç'mënyrë kategorike është larguar Europa nga vlerat dhe autoritetet e saj të traditës së krishterë. Është gjithashtu me interes, si provë se qytetaria europiane shfaqet të jetë një çështje konformiteti ndaj besimesh të caktuara shoqërore të shenjtëruara – në këtë rast, besimi historik anti i krishterë se kundërshtia e ndërjegjshme ndaj praktikës homoseksuale është aq e ligë sa që çdokush e që ka besime të tilla

duhet përjashtuar nga funksionet publike.

Sikurse e vuri re edhe vetë Buttiglione, 'Totalitarizmi i ri i butë që po përparon dëshiron të jetë fe shteti. Është një fe ateiste, nihiliste, por është një fe e detyrueshme për të gjithë'.

Është e mundshme që detyrimi i besimeve shoqërore të behet ende më gjallë, pavarësisht përplasjeve në dukje me principet e lirisë së ndërgjegjjes. Më 2009, Nick Clegg (tashmë zëvendës-kryeministër britanik) u shpreh se fëmijëve që ndjekin shkolla fetare duhet t'u mësohet se homoseksualiteti është 'normal dhe i padëmshëm'. Mësime të posaçme, u shpreh ai, duhet t'u kërkohen shkollave të tilla për të inkurajuar tolerancën ndaj kësaj praktike.

Ngjan e arsyeshme të parashikohet se konkretizimi i këtyre praktikave shoqërore dhe detyrimi i tyre përmes ligjit dhe monokulturës mediatike do të vazhdojë. Shumëkush do të diktojë në to një rikthim në normat historike europiane, të huaja për Islamin, të imponimit të modeleve të një besimi standard mbi subjektet e mbretit. Cuius regio, eius regio.

Liberalizmi i një lloji të posaçëm urdhërues duket se po mbush boshllëkun e lënë nga feja, dhe, në Europë, në tokën e të drejtës së shenjtë të mbretërve, feja është më fort e lidhur me politikën sesa në shtetet myslimane të traditës. Në këtë rast, të dënuarit e sodomisë funksionon si blasfemi, ose si 'dhunë e fjalës'. Blasfemi të tjera përfshijnë, për shembull, idenë se burrat dhe gratë janë përshtatur për detyra të ndryshme, se dënimi me vdekje përbën ndëshkim të drejtë për vrasjen, se prindërit mund të përdorin ndëshkime trupore për të disiplinuar fëmijët e tyre, dhe se jo-besimtarët e kënaqin më pak Zotin se besimtarët. Lista është mjaft e gjatë dhe duket se po rritet.

Shoqëritë i urrejne vakuomet e vlerave. Pas Luftës së Dytë Botërore, Europa dhe Amerika ndoqën rrugë të ndryshme në raport me të vërtetën: Europa shkau në atë çfarë filozofi Heidegger e quajti *gelassenheit* – në të lënë e gjërave të jenë, një humor i cili thjeshtësoi tranzicionin në postmodernizëm. Amerika, zemra e së cilës nuk i vuajti bombardimet e RAF-it ose kampet nazistë të vdekjes, qëndroi e sigurt, në një mënyrë thuajse të thjeshtë, për Zotin dhe vlerat familjare, duke e lejuar alternativën fetare ndaj monokulturës shekullare.

Por, ndërsa kontinenti evropian e përkufizon gjithnjë e në rritje vetveten, jo si një rrënojë e fragmentarizuar lufte, por si një njësi potencialisht e fuqishme, është në nevojë vlerash përbashkuese. Sikurse Amerika, Europa ka ndërtuar tek Islami Tjetrin domethënës, por ndërsa luftërat e jashtme të Amerikës motivohen fetarisht, Europa preokupohet me kohezionin e brendshëm, duke inkuadruar ligje të cilat në Amerikë do të qenë të habitshme: ndryrjen e shamisë jashtë vështrimit, ndalimin e minareve dhe pengimin, në përgjithësi, të shprehjes publike të moralit konservator.

Me fjalë të tjera, bashkimi federal dhe racial, që në Amerikë mundësohet nga luftërat e jashtme kundër myslimanëve, është i mundshëm në një Europë më pak shoviniste vetëm duke i vendosur myslimanët në qendrën e një lufte të brendshme vlerash.

Në të dyja kahet e Atlantikut, intoleranca liberale ose fetare ndaj myslimanëve është rritur tashmë në nivele shqetësuese, dhe legjislacionet e mëtejshme kufizuese janë ngjashëm të mundshme në mjaft vende. 11 shtatori e rriti këtë atmosferë inkuizicioni.

Në Shtetet e Bashkuara, një anketë e Universitetit Cornell përfundon se 44 përqind e amerikanëve e mbështetin tashmë një pezullim të përzgjedhur të të drejtave civile për qytetarët myslimanë. Domethënshëm, disa intelektualë liberale dhe neo-liberalë, mirëpritës ndaj rezultateve të kësaj ankete, e dënojnë shijen e tashme amerikane të pendesës për përqëndrimin e amerikano-japonezëve në

kampe gjatë Luftës së Dytë Botërore.

Aleancat e shenjta

Nëse Europa është duke e rigjetur një lloj bashkimi në alergjinë e saj ndaj myslimanësisë, munden vallë myslimanët të gjejnë aleatë në këtë panoramë? Tarik Ramadani, në librin e tij Të jesh një mysliman europian, nënkupton se martesë është e mundur me grupet mjedisore dhe majtiste, të cilët i druhen rritjes së ndjesisë anti-imigrante. Vrasësi i Pim Fortuyn-it ishte, tek e fundit, një militant majtist vegjetarian, që dëshironte t'i mbronte myslimanët e Hollandës nga planet e Fortuyn-it për persekutim liberal.

Shumë prej myslimanëve të sotëm britanikë dhe europianë duket se e simpatizojnë qasjen e Ramadanit. Kjo aleancë është, megjithatë, e ngjashme të jetë, në rastin më të mirë, një martesë interesi e trazuar. Myslimanët dhe e majta mund të bashkohen mbi Irakun, Izraelin, ose globalizmin, por në çështje vendore qëndrojnë në pole të ndryshme. Lëvizja e Gjelbër, dhe praktikisht e gjithë e Majta, është ashpërsisht pro-homoseksuale dhe feministe. Shfaqet qartë atëherë se, myslimanët europianë e kanë të pangjashme të farkëtojnë një marrëdhënie të qëndrueshme me të Majtën.

Ngjashëm edhe me mjedisorët: shpesh myslimanët harrojnë se rrënjët e lobit të gjelbër në Europë nuk janë monoteiste, por shpesh nënkuptueshëm ose shprehimisht pagane. Nazizmi shfaqte mjaft interes ndaj mjedisit: Sigrid Hunke, feminisja gjermane dhe teoristja e gjelbër e viteve 1930, e cila shihet ende si themeluesja e lëvizjes së gjelbër, përnderohej nga disa ideologë nazistë.

Mjaft myslimanë, nga pikëvështrimi i tyre në getot e Europës, e nuhasin drejt këtë. Por dalin më pas në përfundimin se, me përkufizim, besimtarët e vërtetë nuk kanë aleatë. Disa perspektiva selefiste, në veçanti, duken e kanë të pamundur ta pranojnë mundësinë e partneritetit me jo-myslimanët. Mbahen mend rastet e sikletshme të sheh Feisalit në Britani dhe Enver el Evlakit Shtetet e Bashkuara; ndjekësit e të cilëve, të hipnotizuar nga sllogani 'Kthim në Kur'an', u desh të tërhiqeshin mbrapsht të shqetësuar sapo pikëpamjet politike të këtyre udhëheqësve u pasqyruan në media.

Sakaq, kjo paranojë dhe ksenofobi ngjajnë skripturalisht të panevojshme dhe praktikisht jo të urta. Nëse Europa vijon të shekullarizohet, ndërkaq që xhamitë e Europës mbushen plot, atëherë është e ngjashme se Islami, pa kurrfarë planifikimi apo paramendimi, të bëhet energjia kryesore monoteiste përgjatë pjesës më të madhe të kontinentit, një lloj tharmi në brumin e rëndë të Europës.

Kjo i vendos myslimanët në një pozitë të re historike. Lipset të jetë e mundur të farkëtohen miqësi të ngushta me të tjerë europianë, të cilët e kanë gjithashtu kurajën të blasfemojnë kundër magisterium-it të Brukselit. Mund të ndryshojmë nga katolikët dhe çifutët konservatorë mbi doktrinën, por të gjithë po përballemi me sfida mjaft të ngjashme ndaj vizionit tonë shoqëror. Signor Buttiglione mund të kish qenë fare mirë martir mysliman, e jo katolik.

Këtu, besoj, se barra e përgjegjësive bie mbi shpatullat e udhëheqësve myslimanë. Është në interesin tonë të kërkojmë dhe të ruajmë miqësi. Nuk jemi të vetëm në mospranimin tonë të ndërgjegjshëm ndaj shumë ortodoksive liberale. Deklarata e peshkopit Michel Santer të kishës franceze, që dënoi ndëshkimin zyrtar imponuar mbi gra që mbajnë nikab, është një shenjë e rëndësishme e mundësisë për bashkëpunim.

Për myslimanët, të krishterët dhe çifutët konservatorë sfida do të jetë që të lënë mënjanë hezitimet e forta tradicionale ndaj bashkësive të tjera fetare dhe të zbulojnë shumësinë e gjërave që ndajnë bashkarisht. Sot, qartësisht, industria e ndërfitares ka dështuar ta katalizojë këtë, pjesërisht sepse tenton të drejtohet nga liberalë të zellshëm fetarë. Kemi, me sa duket, gjithnjë e më tepër vullnet të diskutojmë gjithnjë e më pak, dhe të konformohemi gjithnjë e më shumë me konsensusin moral të një bote shekullare dhe individualiste.

Sidoqoftë, një alliance sacrée midis besimtarësh ortodoksë në rajone të ndryshme mendoj se do t'i shfrynte mundësitë e heshtura potencialisht ksenofobe dhe islamofobe në procesin e vetëpërkufizimit evropian. Nëse Europa vetëpërkufizohet kushtetueshmërisht, sikurse besoj se duhet të bëjë, ose si një entitet thelbësisht i krishterë, ose si një i tillë që së paku themelohet në besimin në Zot, atëherë fakti i mbështetjes myslimane për principet thelbësore të etikës së krishterë do t'i jepte Islamit një vend jetik dhe të çmuar.

Por një Europë pastërtisht shekullare do t'i shohë gjithmonë vlerat myslimane si probleme margjinash, të tolerueshme ose të ndëshkueshme sipas tekave të politikanëve të zgjedhur nga çasti. Marrëdhënia me çifutët evropianë nuk është më pak kritike. Nëse çifutët ortodoksë – që po fitojnë tashmë në fuqi – mund të bëjnë kauzë të përbashkët me Islamin për probleme thelbësore morali, shovinizmat dhe dyshimet që gjallojnë në të dyja kahet do të shihen si disfata të vetvetes.

*Abdel Hakim Muradi është dekan i Cambridge Muslim College dhe botues i The Cambridge Companion to Classical Islamic Theology.

Publikuar fillimisht ne www.e-zani.com

Date Created

10/09/2015

Author

erasmusi